



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0217**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Gezime S. Gashi B.I.”, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” me nr. të prokurimit: “616-23-6338-1-1-1”, me 28/05/2024, mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Gezime S. Gashi B.I.” me nr. 2024/0217 , e datës 15/03/2024, kurse vendimi i AK Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Angazhimi i stafit për nevoja të MKRS-së dhe Institucioneve vartëse” me numër të prokurimit 207-23-14360-2-1-1”, mbetet ne fuqi.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Gezime S. Gashi B.I.”.

### **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.06.2023, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” me nr. të prokurimit: “616-23-6338-1-1-1”, Ndërsa me datën 23.02.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë “DHF Company” Sh.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 438,000.00 €.

Me 28.02.2024, OE “Gezime S. Gashi B.I.”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 07.03.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 15.03.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Gezime S. Gashi B.I.”, me nr. 217/24 për lidhur me aktivitetin “Furnizim me pelet” me nr. të prokurimit: “616-23-6338-1-1-1”.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gezime S. Gashi B.I.” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): “Meqenëse kjo është hera e tretë që OE “RRON 2019” parashtron ankesë në OSHP për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pellet” të AK Komuna e Prishtinës dhe OSHP-ja e ka pranuar një përshkrim detal të kronologjisë së këtij aktiviteti të prokurimit, në këtë ankesë do t’i parashtrujmë pretendimet tona ankimore për mos plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes të përcaktuara në dosjen e tenderit nga OE DHF Company ShPK i rekomanduar për kontratë, të cilat kriteret edhe OSHP-ja në vendimet e saj me Nr. 2023/0733 dhe 2023/0970 ka kërkuar të plotësohen gjatë rivlerësimit të ofertave. Pra ZPP dhe Komisioni i Vlerësimit të ofertave nuk i kanë zbatuar vendimet e OSHP-së me Nr. 2023/0733 dhe 2023/0970, që procesi i rivlerësimit të ofertave të bëhet duke u bazuar në kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet”, por kanë rekomanduar për të tretën herë më radhë OE DHF Company ShPK, i cili as në proceset e ri përsëritura të vlerësimit të ofertave nuk i ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosjen e tenderit të këtij aktiviteti të prokurimit. Shkeljet e përsëritura dhe kriteret që nuk i ka plotësuar OE DHF Company ShPK janë: 1. Nuk është zbatuar vendimi i OSHP-së i cili kërkon që OE pjesëmarrës të trajtohen në mënyrë të barabarte dhe pa diskriminim për faktin se ndaj OE “RRON 2019” nuk janë kërkuar fare sqarime për deklarimin me shkrim se posedojmë produktin e kërkuar 60% në depo edhe pse ky kriter është ndryshuar në korigjimin e njoftimit për kontratë, ndërsa nga OE DHF Company ShPK janë kërkuar sqarime. Pra, me qëllim të trajtimit të barabartë dhe jo diskriminimit, AK përderisa ka kërkuar sqarime nga OE DHF Company ShPK është dashtë që të kërkojë sqarime edhe nga OE “Rron 2019. Shkelje të LPP dhe legjislacionit sekondar kanë ndodhur edhe gjatë procesit të sqarimeve, sepse ndaj OE DHF Company ShPK nuk janë

respektuar kërkesat e LPP dhe legjislacionit sekondar për përgjigje në kërkesën për sqarime. Kjo vërtetohet edhe nga fakti se në kërkesën për sqarime që AK ja ka drejtuar OE DHF Company, afati për të kthyer përgjigje në kërkesën për sqarime ka qenë deri me date 26.01.2023 ora 16:00 dhe OE DHF Company ShPK nuk e ka respektuar afatin për përgjigje ndaj AK sipas afatit të përcaktuar, mirëpo është përgjigjur me 19 ditë vonesë apo me datë 14.02.2024. Me këto veprime ZPP dhe Komisioni i Vlerësimit kanë shkelur: - neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP, i cili thotë “Autoriteti kontraktues do t’i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente si dhe autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik”; dhe - neni 38 Sqarimi i Tenderëve, paragrafi 6 dhe 7 i RRPP, të cilët thonë “AK do të caktoj afat kohor të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre. Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet 2. Nuk janë kërkuar dëshmi shtesë për të vërtetuar së furnizimet e paraqitura në listën e furnizimeve janë realizuar në të vërtetë. ZPP dhe Komisioni i vlerësimit edhe në proces të rivlerësimit të ofertave kanë vazhduar me dëshmitë që janë ofruar në ofertën e OE DHF Company ShPK për kontratat dhe referencat dhe për të cilat kemi pretendime se nuk janë binëdse dhe konfirmuese se janë realizuar furnizimet e tilla siç janë prezantuar në listën e furnizimeve (pretendime këto të konfirmuara edhe nga ekspertizat e eksperteve shqyrtues të OSHP-së). Po ashtu në ekspertizat e eksperteve shqyrtues me NR.0733 dhe 0970 është kërkuar që për furnizimet e paraqitura në listën e furnizimeve të ofrohen dëshmi shtesë për furnizimet e realizuara, sepse dëshmitë e prezantuara janë kontradiktore për faktin së janë në të njëjtën datë të lëshimit. Mirëpo këto kërkesa të ekspertizave të eksperteve shqyrtues dhe vendimeve të panelit shqyrtues me Nr. 2023/0733 dhe 2023/0970 nuk është zbatuar. Përveç kësaj Eksperti shqyrtues dhe vendimi i panelit shqyrtues me Nr. 2023/0970 kanë kërkuar që OE DHF Company ShPK të ofrojë ANEKS kontratë se kontrata me Lira – M ka qenë valide për periudhe 6 vjecare dhe është rivazhduar në kohën kur i ka skaduar afati 3 vjeçar i kohëzgjatjes. Për këtë kërkesë të vendimit të panelit shqyrtues me Nr. 2023/0970, nuk është sjellë ANEKS kontrata nga OE DHF Company ShPK, por një deklaratë me shkrim se kinse kontrata është rivazhduar. Një deklaratë e tillë si kjo e dhënë nga OE DHF Company ShPK është e njëanshme dhe nuk ofron bazë për konfirmim të rivazhdimit të kontratës. Gjithashtu ekspertizat e eksperteve shqyrtues kërkojnë që gjatë rivlerësimit të ofertave kontratat dhe dëshmitë e nevojshme në lidhje me referencat dhe listën e kontratave, të vlerësohen duke e respektuar nenin 8 të Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik si dhe Ligjin e Prokurimit Publik, nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, por as kjo kërkesë nuk është zbatuar nga ZPP dhe Komisioni për vlerësimin e ofertave. OE DHF Company shpk nuk ka sjellur aneks kontratë për rivazhdim të kontratës dhe as dëshmi të konfirmuar të livrimit të artikujve të prezantuar në listën e kontratave. Me këto veprime ZPP dhe Komisioni i Vlerësimit kanë shkelur: - Nenin 59 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë; - Nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë sepse është përdorur në mënyrë të njëanshme dhe favorizuese, duke kërkuar sqarime edhe pse dëshmitë dhe faktet kanë qenë të qarta se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.; dhe -

nenin 8 të Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik i cili përcakto se “Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë” dhe nga OE DHF Company ShPK nuk ka kërkuar asnjë dëshmi tjetër për evidentimin e livrimit të tillë. 3. Në nenin 27 “Dosja e tenderit”, paragrafin 3, i LPP dhe me nenin 17 “Dosja e tenderit”, paragrafin 21 të RRPP, thuhet se furnizimet, shërbimet dhe punët që janë lëndë e kontratës duhet të përshkruhen me fjalorin e përgjithshëm të prokurimit (FPP) dhe kodeve të duhura. Kodi i duhur për furnizim me pelet sipas FPP 20161000-2 dhe është i ndryshëm me kodin e lëndës djegëse për të cilin i janë pranuar OE DHF Company ShPK furnizimet e ngjashme në tri vitet e fundit. Poashtu, sipas opinionit të KRPP-së të datës 09.06.2013 si bazë për të përcaktuar termin “të ngjashme” përdoret edhe FPP. Në rastin konkret për lëndën e kontratës “Furnizim me pelet”, FPP është 20161000-2, ndërsa 6/6 referencat dhe lista e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit të ofruara nga OE DHF Company, kategorizohen në FPP 23000000-7. Pra, K.K. Prishtinë nuk ka respektuar dispozitat ligjore dhe opinionin e KRPP-së lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” dhe ka pranuar si furnizime të gjatëshme listën e kontratave të kategorisë furnizim me karburante. Me këto veprime ZPP dhe Komisioni i Vlerësimit kanë shkelur: - nenin 27 “Dosja e tenderit”, paragrafin 3, i LPP dhe nenin 17 “Dosja e tenderit”, paragrafin 21 të RRPP, sepse furnizimet e prezantuara nga OE DHF Company ShPK nuk janë në të njëjtin kod të FPP me lëndën e kontratës “Furnizim me pelte”. ZPP ka bërë shkelje të rënda sipas nenit 97 Shkeljet e rënda, të RRPP sepse nuk i ka respektuar afatet kohore në nxjerrjen e vendimit në kërkesën për rishqyrtim dhe nuk na ka njoftuar neve për afat shtesë për trajtimin e kërkesës për rishqyrtim, siç përcaktohet në RPPP. Këtë mosrespektim të afateve kohore e vërtetojmë më faktet në vijim: 1. Kërkesën për rishqyrtim në AK e kemi parashtruar me datë 28.02.2024, ndërsa vendimin për kërkesën për rishqyrtim e kemi pranuar me 06.03.2024. Pra pas 6 ditëve të punës pas datës së dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. E ritheksojmë s në asnjërin nga proceset e rivlerësimit për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet”, ZPP dhe Komisioni i Vlerësimit nuk i kanë zbatuar kërkesat e vendimeve të OSHP-së që oferta të rivlerësohen duke u bazuar kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në pajtueshmëri me LPP dhe legjislacionin sekondar. Për më tepër ZPP dhe Komisioni i Vlerësimit gjatë proceseve të rivlerësimit të ofertave janë munduar të arsyetojnë dhënien e kontratës të OE DHF Company ShPK dhe jo të realizojnë një proces të drejtë dhe të ligjshëm të rivlerësimit. OE DHF Company ShPK nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit as gjatë proceseve të rivlerësimit dhe nuk ushtron veprimtari të ngjashme me lëndën e kontratës “Furnizim me pelet” siç përcaktohet me kodin e FPP. Po ashtu, ZPP dhe Komisioni i vlerësimit qëllimisht i kanë stërzgatur proceset e rivlerësimit të ofertave dhe i kanë refuzuar kërkesat tona për rishqyrtim, në mënyrë që të realizojnë procedurën e nogociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë për furnizim me pelet me OE të favorizuar prej tyre dhe të cilët ushtrojnë veprimtari të ndryshme me natyrës së lëndës së kontratës.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Gezime S. Gashi B.I.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Nenet 1, 7, 56, 59, 60, 69, 72 të LPP-së, neni 8 i Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik, neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik si dhe Vendimet e OSHP-së me nr. OSHP: 2023/0733 dhe 2023/0970. Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë që të nxjerrët: Vendim Aprovohet, si e bazuar ankesa e

Oe Rron 2019 & N.P.T “Meti Comerc”; Anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së ( B58 ) dhe lënda të kthehet në Rivlerësim; si dhe Të shqyrtohen shkeljet e rënda që i ka përsëritur në vazhdimësi ZPP në K. E Prishtinës dhe të shqyrtohen masat siç përcaktohen me RRPP. Po ashtu OSHP-ja duhet të ndërmarr veprime që rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së, kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, si dhe procesi i rivlerësimit të mos stërzgjetet me qëllim të përdorimit të procedurës së 7/6 negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë, sepse këto veprime të ZPP e ulin besueshmërinë e OE se në procedurat e prokurimit zbatohet korniza ligjore në fuqi.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: “Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm nga ky aktivitet të prokurimit sipas arsyeve të evidentuara në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar si në vijim:Nuk i keni përmbushur kërkesat <? Kapacitetit teknik dhe profesional – ARSYETIMTenderi juaj është refuzuar për këto arsye :Ju si OE-ik me ofertën tuaj nuk keni dorëzuar Deklaratën me shkrim për piken 3 të kërkesën ne I) I, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 dhe 9.2 ku është kërkuar: 5. Operatori Ekonomik duhet të ofroj deklaratë me shkrim gjatë ofertimit se posedon produktin e kërkuar prej 60% të sasisë në depon e tij. Dëshmia e Kërkuar: 3. Deklarate me shkrim e vulosur dhe e nënshkruar se posedon produktin e kërkuar prej 60% të sasisë. si OE-ik nuk keni dorëzuar fare deklaratën c kërkuar sipas kërkesave ne DT c qe keni vepruar ne kundërshtim me kërkesat e DT-së dhe njoftimit për kontrate. Për arsyet e cekura me lartë tenderi juaj është refuzuar dhe. jeni eliminuar për këtë aktivitet te prokurimit.Përmes dosjes së tenderit, kërkesa me nr. 3 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional është përcaktuar si në vijim: 3.Operatori Ekonomik duhet te ofroj deklarate me shkrim gjate ofertimit se posedon produktin e kërkuar prej 60% të sasisë ne depon e tij.3. Deklaratë me shkrim e vulosur dhe e nënshkruar se posedon produktin e kërkuar prej 60% të sasisë. Nuk është aspak kontestues fakti se parashtruesja nuk e ka dorëzuar deklaratën e kërkuar si më sipër me dosjen e tenderit. Kjo konfirmohet edhe nga oferta e parashtrueses ku mund të shihet se nuk është dorëzuar deklarata për të cilën po bëhet fjalë. Fakti i vetëm që kontestohet nga parashtruesja përmes pretendimit ankimor në këtë rast është se kjo kërkesë e cituar më sipër është larguar nga dosja e tenderit përmes B54 Formulari për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara të datës 11.07.2023. Mirëpo ky pretendim si i tillë është në tërësi i pabazuar pasi që përmes formularit të datës 11.07.2023 nuk është larguar kërkesa e dosjes së tenderit për të cilën po bëhet fjalë. Më konkretisht përmes këtij formulari është ndryshuar një kërkesë krejt tjetër e dosjes së tenderit mirëpo nga cilido këndvështrim, kërkesa e cituar më sipër nuk është larguar asesi nga DT. Rrjedhimisht është konfirmuar se oferta e dorëzuar nga parashtruesja është ofertë e papërgjegjshme ndërsa arsyet e evidentuara në formularin standard për eliminimin e parashtruesit janë arsye të sakta. Vlen të ceket se parashtruesja në kërkesën e saj për rishqyrtim ka potencuar edhe ofertën e tenderuesit të rekomanduar për kontratë mirëpo nuk ka arritur që të formuloj ndonjë pretendim ankimor konkret në kuptim të nenit 60 par. 60.3 nën par. f) dhe h) të RRPP ku përcaktohet se pretendimi ankimor përmes kërkesës për rishqyrtim duhet të përmbajë: "f Përshkruan rrethanat faktike që përbejnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar; h. Përshkruan se si është shkaktuar shkelja e pretenduar, apo kërcënon të shkaktojë, dëm material parashtruesit të ankesës në rastet ku parashtruesi i ankesës përfshin një padi për

kompensim". Me fjalë të tjera parashtruesi nuk ka arritur që të formulojë ndonjë pretendim konkret kundër tenderuesit të rekomanduar. Megjithëse parashtruesi në kuptim të nenit 4 par. 1 nën par. 26 të LPP, nuk është fare palë e interesuar në raport me tenderuesin e rekomanduar përderisa vet parashtruesi është tenderues i papërgjegjshëm. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nën paragrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nën paragrafin d) të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik. Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 20.03.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 217/2024, ndërsa me datë 02.04.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/217 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-se për dhënie te kontratës të mbetet në fuqi.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është Pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE nuk është Pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit .

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Gezime S. Gashi B.I.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/217 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues pas pranimit të vendimit B58 dhe letrës standarde të tenderuesit të eliminuar, konform dispozitave të nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-se, dhe brenda afatit ligjor të parapare në nenin 108/A ka dorëzuar ankese në OSHP, me pretendimin se AK-ja nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 të LPP-se. OE ankues, pretendon se AK-Komuna Prishtinës nuk i ka

respektuar vendimin e PSH-se 970/23 dhe njëherit pretendon se AK-ja, nuk ka kërkuar sqarime nga si operatore ekonomik duke na diskriminuar dhe duke vepruar ne kundërshtim me nenin 72 te LPP-se. OE ankues ne ankesën e tij pretendon se nuk është respektuar vendimin i PSH-se nr. 970/23, me arsyetimin se AK-ja nuk i ka kërkuar sqarime OE te rekomanduar për kontrate, lidhur me kontratat, referencat dhe certifikatën e biznesit. Eksperti shqyrtues, sqaron se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues, për faktin se AK Komuna e Prishtinës, sipas udhëzimeve te dhëna ne vendimin e PSH-se nr. 970/23, i ka kërkuar sqarime shtese OE te rekomanduar për kontrate dhe i njëjti ne përgjigje te kërkesës se AK-se, i ka dërguar AK-se sqarime te detajuara për kontratat dhe certifikatën e biznesit. OE ankues ne ankesën tij jep faktet dhe argumentet e veta lidhur me arsyen e eliminimit, për te cilën pretendon se AK-ja është dashur te kërkojë sqarim sipas nenit 72 te LPP-se. OE ankues është eliminuar me arsyetimin se nuk e ka plotësuar piken 3 te kapacitetit teknik dhe profesional, ku AK-ja ka kërkuar: një deklaratë me shkrim te vulosur dhe nënshkruar se OE e posedon 60% te sasisë ne depon e tij. Eksperti shqyrtues pas verifikimit sqaron se ne ofertën e tij OE ankues nuk e ka dorëzuar deklaratën lidhur me sasinë e furnizimit por i njëjti kërkonjë qe mbi bazën e nenit 72 te LPPse, AK-ja është dashur te kërkojë sqarime lidhur me këtë dëshmi. Ky pretendim i OE ankues qëndron sepse AK-ja është dashur të kërkojë duke u bazuar ne nenin 72.4 te LPP-se, për faktin se është dokument i përfshirë ne nenin 69 te LPP-se. Eksperti shqyrtues, sqaron faktin se OE i rekomanduar për kontrate, pasi i ka dhënë te gjitha sqarimet sipas kërkesës se AK-se për kontrata, referenca dhe certifikatën e biznesit, është pa nevojshme qe aktiviteti i prokurimit ne fjale te kthehet ne rivlerësim vetëm për një sqarim te OE ankues, pasi qe OE i rekomanduar për kontrate është me çmim me lire se OE ankues dhe rezultati nuk do te ndryshonte edhe po ti kërkohej deklarata me shkrim lidhur me sasinë e furnizimit.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gezime S. Gashi B.I.” Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertes. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gezime S. Gashi B.I.” janë pjesërisht të bazuara.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas

të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli, shpjegon kjo çështje mund të konsiderohet edhe si çështje e gjykuar konform nenit 105 paragrafi 2.16 i LPP. po ashtu Autoriteti Kontraktues (AK), në kuptim të nenit 1 dhe në përputhje me nenin 115 të Ligjit për Prokurim Publik, nga cilësia e saj si iniciuse e këtij aktiviteti të prokurimit, kishte mundësinë dy herë që të rishikonte sërish vendimin e saj bazuar në gjetjet e ekspertëve shqyrtues, ngase për këtë lëndë ka nxjerrur edhe dy vendime paraprahe Nr. 2023/0733 dhe 2023/0970, duke e kthyer lëndën në ri-vlerësim. Ligji specifikon se nëse AK vërteton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme dhe nuk janë refuzuar nga ankuesi, ata mund të ndërmarrin veprime korrigjuese të rekomanduara nga eksperti. Megjithatë, edhe në këtë rast, AK ka vazhduar të vërtetoj vendimin e saj edhe në kuptim të nenit 6 të LPP. Po ashtu, ankuesi në këtë rast është në vlerë më të shtrejtë se sa OE i rekomanduar për kontratë.

Andaj, Paneli shqyrtues me qëllim të mos prolongimit edhe të mëtutjeshëm të kësaj lënde, vendos që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit dhe dy komisione tjera të ri-vlerësimit, të cilët supozohen të jenë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar "Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës". Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj". Po ashtu, AK ka pasur mundësi dhe çdo kohë në çdo fazë të veproj edhe në harmoni me nenin 52.7 të LPP.



Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është pjesërisht i bazuar, ashtu siç janë dhënë në konstatimin e ekspertit.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafet 1 dhe 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojnë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojnë në mënyrë proporcionale me shkëlqjen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Gëzime S. Gashi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: